RTK RADIO TELEVIZIONI I KOSOVËS
RADIO TELEVIZIJA KOSOVA
RADIO TELEVISION OF KOSOVO
RADIO
Nr. 0095/26
Data 17.07.2026
PRISHTINË

RTK
RADIOTELEVIZIONI I KOSOVËS
RADIO TELEVIZIJA KOSOVA
RADIO TELEVISION OF KOSOVO

Bordi i Radiotelevizionit të Kosovës, në bazë të kompetencave dhe përgjegjësive që burojnë nga dispozitat e Neneve 29 dhe 32 të Ligjit Nr. 04/L-046 për Radiotelevizionin e Kosovës, në pajtim me Nenet 17 dhe 19 të Statutit Nr. 0001/22 të RTK-së, me ndryshime dhe plotësime, në mbështetje të Neneve 14 dhe 15 të Rregullores Nr. 0022/24 për rregullimin e procedurave të konkursit në RTK, si dhe në pajtim me Nenet 3 dhe 5 të Rregullores Nr. 0089/23 për punën e Bordit të RTK-së, në mbledhjen e mbajtur me datë 17.07.2026, merr këtë:

V E N D I M

I. Emërohet Zana Spahiu në pozitën e Drejtoreshës së Përgjithshme të Radiotelevizionit të Kosovës.

II. Mandati i të emëruarës është tre (3) vjet, me mundësi rizgjedhjeje në bazë të konkursit, vetëm edhe për një mandat pasues.

III. Kompetencat, detyrat dhe përgjegjësitë e të emëruarës përcaktohen dhe ushtrohen konform Ligjit Nr. 04/L-046 për Radiotelevizionin e Kosovës, Statutit të RTK-së, si dhe akteve të tjera në fuqi.

IV. Me të emëruarën lidhet kontratë pune për ushtrimin e funksionit të Drejtoreshës së Përgjithshme të RTK-së, me mandat tre (3) vjeçar, në pajtim me legjislacionin në fuqi dhe aktet e brendshme të RTK-së.

V. Ky vendim hyn në fuqi ditën e miratimit nga Bordi i RTK-së.

Arsyetimi

Bordi i Radiotelevizionit të Kosovës, duke ushtruar kompetencat e tij ligjore për emërimin e Drejtorit të Përgjithshëm të RTK-së, zhvilloi procedurën e konkursit publik në pajtim me Ligjin Nr. 04/L-046 për Radiotelevizionin e Kosovës, Statutin Nr. 0001/22 të RTK-së, Rregulloren Nr. 0022/24 për rregullimin e procedurave të konkursit në RTK dhe Rregulloren Nr. 0089/23 për punën e Bordit të RTK-së.

Në bazë të Nenit 32 paragrafit 1 të Ligjit Nr. 04/L-046 për Radiotelevizionin e Kosovës dhe Nenit 19 paragrafit 1 të Statutit të RTK-së, emërimi i Drejtorit të Përgjithshëm bëhet nga Bordi i RTK-së përmes konkursit publik. Në funksion të zbatimit të kësaj dispozite, Bordi, në mbledhjen e mbajtur me datë 18.06.2026, miratoi shpalljen e konkursit publik për pozitën e Drejtorit të Përgjithshëm të RTK-së, ndërsa konkursi u shpall dhe u publikua nga administrata me datë 19.06.2026, në përputhje me Nenin 9 të Rregullores Nr. 0022/24.

Afati për dorëzimin e aplikacioneve ishte i hapur nga data 19.06.2026 deri me datë 06.07.2026, ora 16:00, në përputhje me kushtet dhe afatet e përcaktuara në konkursin publik. Pas përfundimit të afatit të aplikimit, në kuadër të të cilit janë pranuar gjithsej tetë (8) aplikime, Bordi, në mbledhjen e mbajtur me datë 06.07.2026, në pajtim me Nenin 11 paragrafët 1, 2 dhe 3 të Rregullores Nr. 0022/24, ka filluar procedurën e hapjes së dosjeve të aplikimeve, duke shqyrtuar dokumentacionin e dorëzuar dhe verifikuar përmbushjen e kushteve të konkursit.

Pas këtij shqyrtimi fillestar është konstatuar se katër (4) kandidatë i plotësonin kushtet dhe kriteret e konkursit, ndërsa kandidatët që kishin mangësi në dokumentacion janë njoftuan me shkrim, përmes postës elektronike, për arsyet e eliminimit të përkohshëm dhe për të drejtën e plotësimit të dokumentacionit brenda afatit prej dy (2) ditëve të punës, në përputhje me Nenin 11 paragrafët 4, 5 dhe 6 të Rregullores Nr. 0022/24.

Pas skadimit të afatit për plotësimin e dokumentacionit dhe rishqyrtimit të dokumenteve të dorëzuara, Bordi, në mbledhjen e mbajtur me datë 08.07.2026, në pajtim me Nenin 11 paragrafët 1, 2, 3 dhe 7 të Rregullores Nr. 0022/24, ka përfunduar procedurën e verifikimit të dokumentacionit dhe ka konstatuar përmbushjen e kushteve dhe kritereve të përcaktuara me Konkursin Publik. Në përfundim të kësaj faze, Bordi konstatoi se gjashtë (6) kandidatë i kishin plotësuar kushtet dhe kriteret e konkursit dhe miratoi listën përfundimtare të kandidatëve të kualifikuar për intervistim. Të gjithë kandidatët u njoftuan me shkrim për rezultatet e kësaj faze, ndërsa kandidatët e kualifikuar u njoftuan edhe për datën, kohën dhe vendin e zhvillimit të intervistës, në pajtim me Nenin 12 të Rregullores Nr. 0022/24.

Në fazën e intervistimit, në të cilën u paraqitën gjashtë (6) kandidatët e kualifikuar, secili kandidat prezantoi strategjinë, vizionin dhe konceptin zhvillimor për RTK-në, ndërsa anëtarët e Bordit parashtruan pyetje të njëjta për secilin kandidat dhe bënë vlerësimin individual me pikë, sipas kritereve të përcaktuara në Nenin 13 të Rregullores Nr. 0022/24.

Pas përfundimit të intervistimit dhe llogaritjes së rezultateve përfundimtare, me datë 13.07.2026 u hartua lista përfundimtare e renditjes së kandidatëve. Kjo listë është publikuar në ueb-faqen zyrtare të RTK-së, në pajtim me nenin 13 të Rregullores Nr. 0022/24. Sipas kësaj liste, kandidatja Zana Spahiu u rendit në vendin e parë me 90.7 pikë, pasuar nga kandidati Arber Geci me 82.7 pikë, kandidati Lorik Arifaj me 67.6 pikë, kandidati Hysen Hundozi me 65.7 pikë, kandidatja Antigonë Baxhaku me 61.1 pikë dhe kandidati Nexhmedin Spahiu me 61.1 pikë.

Në pajtim me Nenin 14 të Rregullores Nr. 0022/24, duke qenë se kandidatja Zana Spahiu ishte renditur e para në listën përfundimtare të vlerësimit, ajo iu nënshtrua votimit në mbledhjen radhës të Bordit të mbajtur me datë 17.07.2026. Votimi u zhvillua në mënyrë të hapur, në përputhje me Ligjin për RTK-në dhe Rregulloren për punën e Bordit.

Në këtë votim, kandidatja Zana Spahiu mori nëntë (9) vota për, asnjë votë kundër dhe asnjë abstenim, duke siguruar shumicën e kualifikuar prej dy të tretave (2/3) të anëtarëve të Bordit, siç kërkohet nga Neni 32 paragrafi 3 i Ligjit Nr. 04/L-046 për Radiotelevizionin e Kosovës, Neni 19 paragrafi 5 i Statutit të RTK-së dhe Neni 14 paragrafi 3 i Rregullores Nr. 0022/24. Rrjedhimisht, meqenëse kandidatja e renditur e para në listën përfundimtare mori numrin e votave të kërkuara për emërim, procedura e votimit u përmbyll me zgjedhjen e saj.

Duke qenë se procedura e konkursit publik është zhvilluar në përputhje me dispozitat e legjislacionit në fuqi, se kandidatja Zana Spahiu i ka plotësuar kushtet dhe kriteret e përcaktuara me konkursin publik, është renditur e para në listën përfundimtare të vlerësimit dhe ka marrë numrin e votave të kërkuara me ligj për emërim, Bordi i Radiotelevizionit të Kosovës, në ushtrimin e kompetencës së tij sipas Nenit 29 paragrafit 2 nënparagrafit 2.6 të Ligjit Nr. 04/L-046 për Radiotelevizionin e Kosovës, vendosi për emërimin e saj në pozitën e Drejtoreshës së Përgjithshme të Radiotelevizionit të Kosovës për mandat tre (3) vjeçar, me mundësi rizgjedhjeje në bazë të konkursit vetëm edhe për një mandat pasues, në pajtim me Nenin 32 paragrafin 3 të Ligjit, Nenin 19 paragrafin 5 të Statutit të RTK-së dhe Nenin 15 të Rregullores Nr. 0022/24.

Në bazë të asaj që u cek më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Dardan Begiri

Kryetar i Bordit të RTK-së

Nga një kopje e Vendimit iu dërgohet:
- *Të emëruarës;*
- *Anëtarëve të Bordit të RTK-së;*
- *Menaxhmentit të lartë të RTK-së;*
- *Sekretariatit të Bordit të RTK-së;*
- *Administratës dhe Burimeve Njerëzore të RTK-së; dhe*
- *Arkivit të RTK-së.*

Këshillë juridike: Kundër këtij Vendimi, kandidati i pakënaqur ka të drejtë të paraqesë padi në Gjykatën Themelore në Prishtinë, në afat prej tridhjetë (30) ditëve nga dita e pranimit të njoftimit me Vendimin për emërimin e Drejtorit të Përgjithshëm të RTK-së.